



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
UNIVERSITETI I ARTEVE  
BORDI I ADMINISTRIMIT

Nr. 833/1 Prot.

Tiranë, më 10.07.2024

VENDIM

Nr. 14, DATË 10/07/2024

MBI

**“MIRATIMIN E SHPËRNDARJES SË GRANTIT TË TRASHËGUAR NGA VITI 2023  
DHE SHITESË E REGJISTRIT TË PROKURIMEVE PËR VITIN 2024”**

Në mbështetje të ligjit nr. 80/2015 “Për Arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, neni 3 (Liria akademike dhe autonomia e institucioneve të arsimit të lartë), neni 49 (Funkcionet e Bordit të Administrimit), të Statutit të UART dhe sipas materialit bashkëlidhur të Administratores së UART, pas shqyrtimit dhe diskutimeve, Bordi i Administrimit të UART,

V E N D O S I:

1. Miratimin e shpërndarjes së grantit të trashëguar nga viti 2023 dhe shtesën e regjistrit të prokurimeve për vitin 2024, sipas relacionit bashkëlidhur.
2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**BORDI I ADMINISTRIMIT I UNIVERSITETIT TË ARTEVE**

Lavdrim SAHITAJ


(Kryetar)

Prof. Besnik Bisha

(Anëtar)



Jeton SHEHU

  
(Anëtar)

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

Prof.Asoc.Dr. Sokol SARAÇI

  
(Anëtar)

Ergis SEFA

  
(Anëtar)

Lorenc VANGJELI

\_\_\_\_\_  
(Anëtar)



Vladimir Llakaj

  
(Anëtar)



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
UNIVERSITETI I ARTEVE  
ADMINISTRATOR

Nr. 833 prot.

Tiranë, më 26/06/2024

Propozim për shpërndarjen e grantit të trashëguar nga viti 2023 dhe shtesë të regjistrit të prokurimeve për vitin 2024

Bordit të Administrimit të Universitetit të Arteve

Fondet e trashëguara nga vitet paraardhese për vitin 2024, me burim financimi buxhetin e shtetit (grant), janë paraqitur në tabelën e mëposhtme.

Art.	Emertimi	Kap.	Vlera (lek)
600	Paga	8	9,720,307
601	Sigurime shoqer. dhe shendet.	8	1,679,701
602	Mallra dhe shërbime te tjera	8	10,922,997
602	Fondi për ndërkombtarizimin e programeve të studimit	8	10,319,641
605	Transferimet korrente jashtë	8	356,274
606	Ndihme & rimbursime	8	9,621
606	Bursa per studentë	8	12,986,773
<b>TOTALI</b>			<b>45,995,314</b>

Duke marre ne konsiderate qe zërat “Bursa për studentë” dhe “Fondi për ndërkombëtarizimin e programeve të studimit”, janë fonde të cilave nuk mund t’ju ndryshohet destinacioni i përdorimit, propozojme qe shperndarja e grantit te trasheguar nga vitet paraardhese te jete si ne tabelen e meposhtme:

Art.	Emertimi	Kap.	Vlera (lek)
602	Mallra dhe shërbime te tjera	8	3,363,349
602	Fondi per nderkomb. e programeve te studimit	8	10,319,641
606	Bursa	8	12,986,773
	Fonde te pashpërndara	8	19,325,551
<b>TOTALI</b>			<b>45,995,314</b>



Në zërin e “Mallra dhe shërbime” janë pefshire:

- **Taksë bashkiake** - ne shperndarjen e grantit per vitin 2024, te miratuar me VBA me Nr. date, u miratua pagesa per taksen bashkiake me vlere 850.000 lek. Kjo pagese u planifikua bazuar ne pagesat e viteve te meparshme. Ne prill 2024, Bashkia tirane na dergon detyrimin per vitin 2024, i cili ishte 992.004 lek, pra me rritje prej **142.000 lek**.
- **Tarifë Qendra Nderinstitucionale e Rrjetit Akademik (QNRA)** – bazuar ne kontratën Nr.1871 prot. Date 16.12.2024, te lidhur ndermjet QNRA (*krijuar me Ligjin Nr.9704 date 02.07.2017 dhe riorganizuar VKM Nr.88 date 14.02.2018*) dhe Universitetit te Arteve, objekt i te ciles ishte ofrimi nga QNRA i sherbimeve informatike dhe internetit per UART, QNRA ka faturuar sherbimin per vitin 2022 me vlere 1.203.365 lek dhe per vitin 2023 me vlere 1.151.980 lek, pra ne nje total **2.355.345 lek**.
- **Organizimi nga Fakulteti i Muzikës i Konkursit per Instrumentiste “Ymer Skenderi” Edicioni I** – Fakulteti i Muzikes parashikon te organizoje konkursin per instrumentiste, me qellim promovimin e artistëve të rinj studentë pranë UART dhe nga gjithë shkollat e ngjashme në botë, si dhe rritjen e interesit për të studiuar në UART. Shpenzimet e organizmit te ketij konkursi (preventivi bashkangjitur materialit) parashikohen të jenë **866.000 lek**.

Në zërin e “Fonde te pashpërndara ” – ky zë është parashikuar për të mbuluar shpenzimet për paga dhe sigurime shoqërore dhe shëndetësore, si pasojë e rishikimit të titujve të personelit akademik në UART, që do të miratohen nga organet drejtuese të UART.

Universiteti i Arteve, Fakulteti i Arteve të Bukura, ka aplikuar pranë AKKSHI dhe është shpalluar fitues me projektin “Shtim pajisjesh dhe modernizimi i laboratorëve të FAB (Laboratori i Qeramikes dhe i Skulpturës)”. Vlera e financimit, e cila do të mbulohet e gjitha nga AKKSHI, do te jetë **9.627.120 lek** e shperndare në dy vite, përkatesisht **6.980.700 lek për vitin 2024** dhe **2.646.420 lek për vitin 2025**.

Referuar sa me sipër, kërkojmë shtesë në rregjistrin e prokurimeve për vitin 2024, si në tabelën e mëposhtme:

Nr.	Emertimi	Vlera (lek)
1	Vegla pune për Laboratorin e Qeramikës dhe Skulpturës	1,902,620
2	Pajisje për eksperimente pranë Lab.te Qeramikës dhe Skulpturës.	1,983,500
3	Pajisje për Laboratorin e Qeramikës dhe Skulpturës.	4,546,000
4	Kompjuter, printer, monitor e të ngjashme për Lab. e Qeramikës dhe Skulpturës.	1,195,000
TOTALI		9,627,120

